



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. i prot. 4707 M 17-11 20 20
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

ANEKS KONTRATA

NDËRTIMI I SISTEMIT TË KULLIMIT (DRENASHIMIT) TË TOKAVE BUJQËSORE GEXHË, MALËSI E VOGËL DHE RATKOC

Nr. Ref. 623-20-7351-5-2-5

Nr. i brendshëm. 623-13-073-5-1-1/5

Autoriteti Kontraktues: KOMUNA E RAHOVECIT, dhe





“PROing&Partners” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kujtim Zena & “LG Construction Group” Sh.p.k. me adresë në Suharekë, të cilën e përfaqëson Lulëzim Gashi, në tekstin e mëtejshëm (“Kontraktuesi”), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontratë:

- I. Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: [Ndërtimi i sistemit të kullimit (Drenashimit) të tokave bujqësore Gexhë, Malësi e vogël dhe Ratkoc], me nr. të prokurimit [623.13.073.511], të datës: [01.10.2013], e cila kontratë është në realizim e sipër.
- II. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për [Ndërtimi i sistemit të kullimit (Drenashimit) të tokave bujqësore Gexhë, Malësi e vogël dhe Ratkoc], Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës [11.11.2020] me kushte të njëjta si në kontratën bazë.
- III. Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe/ose shërbimeve duhen të përfundohen në afat jo më të gjatë se: 20 ditë pune pas fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe/ose Shërbimeve.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **49,699.56 €**
(Katërdhjetenëntë mijë e gjashtëqindnëntëdhjetenëntë Euro e pesëdhjetegjashtë Cent)
sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. [623-20-7351-5-2-5 & 623-13-073-5-1-1/5].
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas përfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.

6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.
 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Kujtim Zena
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	17.11.2020	Data:	17.11.2020
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA PUNËT SHITESË

EMRI I KONTRATES:	Sistemi I kullimit (Drenazhimit) _Gexhë, Malësi e vogël dhe Ratkoc-KIK- RAHOVEC
NUMRI I PROKURIMIT:	623/13/073/511
KONTRAKTORI:	PROing&Partners SHLPK& LG construction Group
INVESTITORI:	KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC

PARAMASA DHE PARALLOGARIA (PUNËT SHITESË)

Nr.	Përshkrimi i punëve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera Totale
II PUNIMET TOKËSORE					
	Gërryerja dhe largimi i humusit , dheut dhe materialeve tjera që dalin në vendpunim me makinë, dhe me dorë në kategorinë e II-III në tërë sipërfaqen e profilave të rregulluar sipas projektit. Humusit i shëndosh duhet të ruhet, kurse materiali i panevojshëm të bartet deri në deponi në më të afërt, të caktuar nga organi mbikqyrës, gjithnjë sipas dispozitave udhëhoqëse të organit mbikqyrës.				
2.1	Me makinë 90%	m ²	5400.00	0.60	3,240.00
2.2	Me dorë 10%	m ²	540.00	0.10	54.00
2.7	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja (kompaktësimi) i zhavorit (0-31) mm nën pllakën e betonit të varfur të kanalit në tërë gjatësinë e tij.	m ²	537.6	4.00	2,150.40
PUNIMET TOKËSORE			II	Gjithsej:	5,444.40
IV PUNËT E BETONIMIT					
4.1	Betonimi i pllakës së poshtme të kanalit me beton të varfër C-12/16 (t=5.0cm).	m ³	94.50	2.00 €	- 189.00
4.2	Furnizimi, transporti dhe betonimi i pllakës së poshtme dhe mureve anësore të kanalit me beton C 20/25 me trashësi sipas detajeve të projektit. Çmimi për njësi përfshin: Sigurimin, transportimin, kallëpimin, vuarjen në vepër, si dhe ekzaminimin e mostrave të betonit në laboratorët e certifikuar në sasi sipas normave.	m ³	508.50	47.00 €	23,899.50
PUNËT E BETONIMIT			IV	Gjithsej:	24,088.50
V PUNËT E ARMATURËS					
5.1	Armimi i pozitave të betonit të armuar sipas detaleve të armaturës. Çmimi për njësi përfshin: Furnizimin, transportimin, prerjen, lakimin, montimin e shufrave të çelikut. Armatura me dim. Ø8 mm duhet të vendoset në kanal sipas vizatimeve.	kg	22882.50	0.55 €	12,585.38
PUNËT E ARMATURËS			V	Gjithsej:	12,585.38
REKAPITULIMI I PUNIMEVE:					
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONEVE	SHUMA (€)			
II	PUNIMET TOKËSORE	5,444.40			
IV	PUNËT E BETONIMIT	24,088.50			
V	PUNËT E ARMATURËS	12,585.38			
	TOTALI PA TVSH:	42,118.28			
	TVSH 18% :	7,581.29			
	TOTALI ME TVSH:	49,699.56			

PUNËKRYESI: PROing & Partners SHLPK

